



**Informimi javor për median  
Dhomat dhe Zyra Administrative**

N°10/2021

Hagë, 18/11/2021

**Përditësim**

Mirë se vini në informimin javor për median të Dhomave të Specializuara të Kosovës, ku synojmë t'ju ofrojmë një përditësim mbi zhvillimet e fundit në Gjykatë si dhe informacion për javën e ardhshme.

Të mërkurën dhe të enjten dëshmoi dëshmitari i shtatë në gjykimin e Salih Mustafës. Dëshmitari dha dëshmi lidhur me zhvarrosjen e një trupi në Zllash. Dëshmitari ka dëshmuar me masa mbrojtëse, përfshirë përdorimin e një pseudonimi si dhe ndryshimin e fytyrës dhe të zërit. Seanca e radhës në këtë çështje do të mbahet të hënën, më 22 nëntor.

Bazuar në vendimin e Gjykatësit të Procedurës Paraprake më 18 tetor 2021, Prokurori i Specializuar ditën e mërkurë dorëzoi versionin e redaktuar publik të Aktakuzës së korigjuar të çështjes *Pjetër Shala*. Aktakuza e korigjuar gjendet në faqen tonë të internetit në të tri gjuhët e gjykatës.

Gjatë kësaj jave dhe javës së shkuar, disa prej ekipeve të Mbrojtjes në çështjen *Hashim Thaçi dhe të bashkakuzuarit* dorëzuan apele kundër vendimeve të Gjykatësit të Procedurës Paraprake mbi mangësitë në aktakuzë dhe mbi shkeljet e pretenduara të disa të drejtave kushtetuese. U caktuan panele të Gjykatës së Apelit për të vendosur lidhur me këto apele dhe vendimet përkatëse do të nxirren në kohën e duhur. Parashtrimet përkatëse gjenden në faqen zyrtare të DHS-së.

**Pyetje nga gazetarët  
Nuk pati pyetje**

